



DRTK SHKODËR
SEKTORI I
ARKITEKTURËS

MIRATOHET

Për K. K. T. K. M

Sekretari

Endri HAXHIU

RELACION TEKNIK

RESTAURIM DHE KONSERVIM I PLOTË NË FASADAT E OBJEKTIT "GALERIA E ARTEVE, ISH BASHKIA E QYTETIT TË SHKODRËS", SHKODËR



SHKURT 2026

PËRMBAJTJA :

<i>Hyrje.....</i>	<i>3</i>
<i>Vendodhja</i>	<i>4</i>
<i>Përshkrimi arkitektonik</i>	<i>5</i>
<i>Problematika dhe ndërhyrje.....</i>	<i>9</i>
<i>Bibliografia.</i>	<i>14</i>

Hyrje

Objekt i këtij projekti restaurimi është pasuria kulturore Galeria e Arteve, ish Bashkia e qytetit të Shkodrës.

Në çdo projekt restaurimi faza e parë e projektit është ajo e konsultimit të materialeve arkivore, hulumtimi i materialeve historike që disponon DRTK Shkodër në lidhje me këtë objekt si dhe studimi i materialeve të vëna në dispozicion nga IKTk Tiranë. Kjo fazë është e rëndësishme për të ndërtuar kronologjinë historike të pasurisë kulturore, dokumentimin e ndërhyrjeve restauruese të mëparshme, si edhe evidentimin e ndryshimeve që kanë ndodhur me kalimin e kohës. Puna kërkimore është pasuar nga rilevimi fotografik i objektit që do të restaurohet, rilevimi gjeometrik për të hartuar pastaj dhe rilevimin arkitektonik.

Rilevimi gjeometrik ndihmon në vizatimin e saktë të planimetrive, ndërsa rilevimi fotografik vjen në ndihmë të dokumentimit të zonave ku do të fokusohen këto ndërhyrje.

Një rilevim arkitektonik i kujdesshëm dhe evidentim sa më i detajuar i degradimeve do ndihmojë për hartimin e një projekti restaurimi sa më të plotë dhe efikas.

Materiali është i organizuar si më poshtë: pjesa që i përket studimit historik të godinës, përshkrimi arkitektonik i saj, për të vazhduar me problematikën, ndërhyrjet, specifikimet e ndërhyrjeve restauruese.

Vendodhja

Galeria e Arteve, ish Bashkia e qytetit të Shkodrës., ndodhet në qytetin e Shkodrës jo shumë larg nga qendra e qytetit.



Fig 1. Harta e Shqipërise, evidentim i qytetit Pukë




Fig 2. Ortofoto, evidentim i godinës

Përshkrimi arkitektonik

Galeria e Arteve, ish Bashkia e qytetit të Shkodrës është pasuri kulturore me status monument kulture e kategorisë së parë shpallur nga Ministria e Kulturës dhe e Arsimit me vendim Nr.377 datë 22.01.1985.

Kjo ndërtesë sipas Hamdi Bushatit ishte pronë e disa bejlerëve Bushatlinj, të cilët ia dhuruan në atë kohë shtetit. Nga viti 1990 komanda e ushtrisë turke e ndërtoi për klub oficerësh dhe mensë të tyre. Pas largimit të forcave turke, në vitin 1916 u bë ndërtesë e zyrave të Bashkisë. Ndërtesës me këtë rast iu bënë zbulime të tavanit, si dhe në fasadën kryesore, mbi ballkon u vendos një orë. Gjatë viteve të sistemit komunist u shfrytëzua si ndërtesë e Komitetit Ekzekutiv të qytetit. Mbas viteve 1990 u bë ndërtesa kryesore e bashkisë së qytetit dhe gjatë kësaj kohe iu bë një rikonstruksion i përgjithshëm dhe një zgjerim i pjesshëm i ambienteve. Pas viteve 2010 kjo ndërtesë u bë qendra zyrtare të Prefekturës dhe e Qarkut të Shkodrës.

Ky objekt u shpall monument kulture nga Ministria e Arsimit dhe e Kulturës përmes vendimit nr.377 prot., datë 22.01.1985, për shkak të vlerave historike dhe arkitektonike që ndërtesa ka. Referuar vendimit të shpalljes thuhet se: “Nga ballkoni i kësaj ndërtese në vitin 1936 shoku Enver Hoxha i foli popullit të Shkodrës me rastin e mbartjes së eshrave të patriotëve të shquar Çerçiz Topullit e Muço Qullit.”



Foto 3. Material arkivor, marrë nga Prefektura

Problematika dhe ndërhyrje

Kjo godinë nuk ka qenë objekt restuarimi dhe mirëmbajtje ndër vite. As në arkivin e DRTK Shkodër si dhe pranë arkivit të IKTK-së nuk kemi arritur të marrim material arkivor që ti referohemi gjatë hartimit të projektit.

Gjendja e objektit duket shumë e amortizuar, kryesisht në fasadën kryesore ku vihet re degradimet e suvatimeve dhe të elementeve drusore në dritaret e ndërtesës.

Projekti i ndërhyrjes konsiston në restaurimin e plote të fasadave të objektit monument kulture.



Foto 4. Foto e fasadës kryesore



Foto 5. Foto e fasadës anësore



Foto 6. Foto të fasadës



Foto 7,8,9,10. Foto të dritareve ne fasadë

Bibliografia

Bushati, Hamdi. “Shkodra dhe motet”, vëll, I, II

Dibra, Zenepe. “Fjalor enciklopedik i hapësirës shkodrane”, vol 2

Punoi: Elson Laqja

Oltion Cuni

Fatjon Mlloja

Sabrina Kuci

